


REPUBLIKA E KOSOVËS - KOMUNA VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga takimi me qytetarë mbajtur në fshatin Smrekonicë, lidhur me dëgjimet buxhetore për vitin 2022-2024

Mbledhja u mbajt me datën 28.08.2021 me fillim në ora 19:00, në Shkollën "Enver Hadri".

Prezent nga zyrtarët e komunës:

1. z. Xhafer Tahiri- kryetar i komunës
2. z. Afrim Namani –nënkryetar i komunës, etj.

Nga banorët e atij lokaliteti ishin të pranishëm 17 pjesëmarrës. Prej tyre 16 meshkuj dhe 1 femër.

Rend Dite

1. Dëgjimet buxhetore për buxhetin e vitit 2022-2024

Fjala hyrëse:

Kryetari i komunës zotëri Xhafer Tahiri fillimisht i njoftoj të pranishmit në pika të shkurtra lidhur me investimet e bëra gjatë këtyre viteve të udhëheqjes së tij me komunën, duke filluar me projektet infrastrukturore si shtrimin e rrugëve me asfalt, subvencionet e dhëna për fermerët, investimet në objektet edukativo-arsimore, ndërtimi i fushave sportive, rregullimin dhe mirëmbajtjen e shtatit të lumenjve, rregullimin e shesheve në qytet, prurjen e ujit të pijes në pothuajse tërë territorin e komunës, menaxhimin e mbledhjes së mbeturinave, projekti pothuajse në mbarim për ndërtimin e zonës ekonomike, etj.

Pas përfundimit të fjalës hyrëse, u hap diskutimi:

1. Sylejman Bejta, thekson çështjen e hedhjes së mbeturinave në fshatin Smrekonicë nga qytetar të pandërgjegjshëm nga banorë të fshatit Pasomë.
2. Bastri Osmani, kërkon të rregullohen rrugët: “Ferat Hasani” dhe tjetra afër saj.
3. Blerim Hasani, kërkon të ndriçohet pjesa afër rrugës “Izet Sefedini”
4. Ramadan Pajaziti, kërkon që të rregullohet rruga 100 “Iagjja Pajaziti”.
5. Milazim Bejta, kërkon të rregullohen tri urat e fshatit.

Në fund të këtij takimi u theksua se këto kërkesa do të shqyrtohen në ekzekutivin e komunës, Komitetin për politikë dhe financa dhe rekomandohen për miratim në kuvendin e komunës për aprovim varësisht prej prioritetëve që do të përcaktohen si dhe varësisht prej disponueshmërisë buxhetore për investime kapitale për v. 2022-2024.

Procesmbajtës:

Premtim Maloku

